



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1134/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Musa Bislimi kandidat për asamble kuvendit komunale nga subjekti politik Lëvizja për Bashkim (LB) në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të parregullsive dhe manipulimit të votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Musa Bislimi kandidat për kuvendin komunal në Prishtinë nga e subjektit politik Lëvizja për Bashkim.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Musa Bislimi anëtar për asamble komunale nga Lëvizja për Bashkim i cili thekson se me datën 03.11.2013 unë kam votuar në qendrën e votimit 1920E/03R, ku në bazë të rezultateve preliminare të KQZ-së në vendvotimin e cekur me lartë nuk figuron 0(zero) vota dhe në bazë të vëzhguesit nga LB-ja Muhamet Ajeti në këtë qendër votimi unë i kam pasur gjithsejt 36 vota. Parashtruesi i ankesën deklaroi se në këtë qendër mungon vota edhe vota ime personale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga dëshmit e ofruara dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Musë Bislimi nga komuna e Prishtinës PZAP-i, vlerësoi si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1134/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.